



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 09.03.2021

FTESË PËR NEGOCIATA

Të nderuar,

Bazuar në VKM nr. 1102, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2021”, në VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve apo të reklamave për trasmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar dhe për kontratat për kohë transmetimi nga organet e administratës, si dhe në Udhëzimin nr. 9, datë 26.02.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”,

Objekti i programit të reklamës: Informimi mediatic i publikut lidhur me masat mbështetëse të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2021.

Nevoja për kryerjen e reklamave: Me anë të kësaj fushate komunikimi do të bëhet e mundur realizimi i objektit “Për aktivitetet informuese për publikun lidhur me masat mbështetëse nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2021” dhe marrja e informacionit në të gjithë territorin e vendit me fokus kryesorë zonat rurale.

Të zhvillohet procedura e blerjes, zhvillimit dhe prodhimit të spotiteve/reklamave: “Për informimin mediatic të publikut të gjerë, lidhur me implementimin e masave të mbështetjes për vitin 2021” si: “Mbështetje në fushën e bujqësisë, blegtorisë, për vitin 2021”, me fond limit 19.998.520 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e njëzet) lekë pa TVSH.

Ideimi i spoteve/video informuese të kryhet nga organet e masmedias të specializuara në këtë fushë dhe transmetimi të kryhet nga masmedia on-line (portale informative), printime Roll up, portale on- line, reklamim në Facebook, printim fletëpalosje katër faqe, printim posterash një faqe, Transmetim TV, video live session.

Objekti i programit të spoteve/reklamave për sektorët që do të mbështeten, nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, është si më poshtë:

- rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve blegtorale, të prodhimeve bujqësore në mjedise të mbrojtura dhe uljen e kostove të prodhimit, nëpërmjet pagesave të kafshëve të matrikulluara e subvencionimit të çmimit të plastmasës;
- shtimin e sipërfaqeve të mbjella me bimë mjekësore dhe aromatike;
- certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike;
- mbështetjen e diversifikimit të aktiviteteve ekonomike në zonat rurale.

TEKSTI DHE KONTENTI

Agjencia për zhvillim bujqësor dhe Rural shpall thirrjen për aplikime nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural, për vitin 2021.

Aplikimi për masat direkte dhe për masat e investimeve do të bëhen nga data 24.03.2021 deri më 15.04.2021.

Bazuar në VKM nr. 1102, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2021”, të sektorëve që do të mbështeten dhe masës së financimit për vitin 2021, për:

Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

a) Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermat me jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1 200 (njëmijë e dyqind) lekë/krerë, por jo më shumë se 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për subjekt, ndërsa për fermat me jo më pak se 5 (pesë) krerë lopë, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt;

b) Mbarështim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt;

c) Zëvendësimi i plastmasës termike për serrat diellore ekzistuese për prodhimin e perimeve, rrushit për tavolinë dhe tunelet plastike për prodhimin e luleshtrydhes në vlerën respektive 300 000 (treqind mijë) lekë/ha dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë/ha, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt. Sipërfaqja e serrës apo e tunelit plastik të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha. Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.

ç) Mbjellje bimësh mjekësore e aromatike në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë për fermerët individualë dhe për grup fermerësh, ndërsa për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (në vijim “SHBB”), jo më shumë se 4 000 000 (katër milionë) lekë. Sipërfaqja e mbjellë për fermerët individualë duhet të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha, për grup fermerësh, jo më pak se 1 ha në një bllok të vetëm, për SHBB-të, jo më pak se 5 (pesë) ha. Madhësia e ngastrës të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha, kur nuk është në bllok.

d) Fermat organike, për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar.

dh) Implementimi dhe certifikimi Global GAP në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore, por jo më shumë 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, në perime, fruta, rrush, ullinj dhe agrume, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha.

e) Mbështetje për linja/makineri/pajisje për përpunimin, paketimin, standartizimin dhe etiketimin e ullirit, vajit të ullirit, bimëve mjekësore e aromatike dhe qumështit në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milion) lekë për subjekt.

Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga Programi IPARD II.

Mbështetje për ngritjen ose rikonstrukcionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 (gjashtë) deri në 10 (dhjetë) dhoma, në 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.

Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.

Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milion) lekë për subjekt.

Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga Programi IOARD II.

Thirrja për aplikime do të qëndrojë e hapur nga data 24.03.2021 deri më 15.04.2021

Informacioni për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe procedurat deri në përfitimin e mbështetjes financiare gjendet pranë 20 Agropikave në qytetet: Tiranë, Durrës, Kavajë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Elbasan, Librazhd, Pogradec, Korçë, Përmet, Gjirokastër, Sarandë, Lezhë, Shkodër, Pukë, Kukës, Dibër, Mat.

16 zyrat e Agjencive Rajonale të Ekstensionit të Bujqësisë

Zyrave qendrore të AZHBR

Si dhe në faqen e internetit www.azhbr.gov.al

Aplikimet për masat mbështetëse direkte me nr. 1-6 do të bëhet online;

Aplikimi on-line bëhet mbi bazën e parimit “zero dokumenta” në momentin e aplikimit;

Aplikimi on-line do të bëhet pranë në portalin e-albania. Aplikantët kur e kanë të nevojshme gjatë procesit të aplikimit të asistohen on-line, nëpërmjet **Numrit Jeshil** 0800 8383, nga Specialistet e Agropikave, Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, si dhe të shërbimit on linë (call center) nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

Përfitues për masat mbështetëse të mësipërme mund të jenë fermerë individualë, grup fermerësh, persona fizik, juridik, SHBB;

Aplikimi on-line është i mundshëm përgjatë 24 orëve nga data e hapjes deri në përfundim të periudhës së aplikimit.

Procedura e aplikimit nga portali e-albania, përfundon me dërgimin me sukses të formatit elektronik të formularit të aplikimit.

Aplikimi me dosje në AZHBR

Aplikimet për masën mbështetëse të investimeve me nr. 7-9 do të bëhen me dosje në zyrat qendrore të AZHBR;

Për qëllime identifikimi, aplikanti sipas statusit përkatës (person fizik/juridik), ose përfaqësuesi i tij me prokurë ose autorizim, duhet të paraqitet në zyrat qendrore të AZHBR me letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike.

1. TV – 1 (një), Spot për 9 Masat e skemave mbështetëse për vitin 2021, spot i cili të jetë 40-45 sekonda, ku të jenë të cilësuar 6 masat e para 1-6 janë online dhe kryhen nga vetë aplikanti nëpërmjet portalit e-Albania dhe 3 masat e tjera 7-9 janë me dorëzim dosje aplikim në AZHBR qendër.

- **Shpeshtësia jo më pak se 5 herë në ditë.**
- **Numri i spoteve (reklamave) me xhirime që do të realizohen do të jetë 1 (një).**
- **Operatori merr përsipër të krijojë konceptin, skenarin dhe storyboarding të spotit.**
- Spoti duhet të përmbajë xhirime cilësore (HD).
- Regjistrimet dhe prodhimi i spotit duhet të përfshijë : sekuenca, plane detaje dhe të përgjithshme, elemente grafike të shoqëruara me titra, pamje që tregojnë gjeografinë e vendndodhjes dhe filmime në lartësi (nese do te kerkojen).
- Komplekse blegtorale kullota plane në perspektivë që tregojnë zhvillimin rural.
- Pamje kodrinore apo fusha në mbjella me kultura bujqësore, linja përpunimi prodhimi, etj
- Kohëzgjatja e transmetimit publik duhet të jetë 10 ditë (Transmetimet duhet të jenë gjatë audiencës maksimale, para edicionit të Lajmeve në televizionet Kombëtare).
- Audio dhe kolona zanore e spotit duhet të jenë cilësore me parametra 4/8khz dhe 24-bit depth.
- Efektet audio dhe efektet muzikore që do të shoqërojnë spotet të zotërojnë të gjitha të drejtat e përdorimit pa limit në hapësirë gjeografike apo kohore.
- Spoti do të shoqërohet me voiceover dhe/ose me titra.
- Spoti duhet të shoqërohet me sloganin kryesor dhe logot zyrtare të MBZHR, AZHBR.
- Produkti final duhet të jetë format HD 1080, si dhe të dorëzohet në format Digital CD/USB.
- Spoti do të transmetohet ne TV Kombëtare, 5 (pesë) ditë para celjes së Thirrjes dhe 5 (ditë) gjatë Thirrjes.

Afati i dorëzimit të spotit 4 ditë kalendarike nga Lidhja e Kontratës.

2. Video trajnuese për mënyrën e Aplikimit.

- Video trajnuese 2 (dy) « motion – graphic », gjatësia e secilës video duhet të jetë jo më e vogël se 1 (një) minutë, në varësi të materialit të dhënë nga AZHBR.
- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin skenarin dhe storyboardin e videos trajnuese. Cilësia e videos duhet të jetë e standartit HD.
- Të përmbajë imazhe grafike shpjeguese sipas nevojës.
- Audio dhe kolona zanore duhet të jetë cilësore me parametra 48 khz dhe 24 bit depth.
- Efektet audio dhe baza muzikore që do të shoqërojnë videon trajnuese të zotërojnë të gjitha të drejtat e përdorimit pa limit në hapësirë gjeografike dhe kohore.
- Video do të shoqërohet me voiceover dhe mesazhi të jetë i sintetizuar dhe/ose i shoqëruar me titra. Videot duhet të përmbajnë sloganin kryesor, logon zyrtare të AZHBR dhe MBZHR, si dhe adresën e internetit përkatës.
- Produkti final duhet të jetë format video HD 1080, si dhe duhet të dorëzohet në format digital CD ose USB.

Afati i dorëzimit 4 ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

Shërbimet, komponentët

1. Fletë palosje, katër faqe, 15.000 copë

- a. Me ngjyra
- b. Letër 115 gr
- c. A4

2. Printim posterash, 1 faqe, 100 copë

- a. Me ngjyra
- b. Letër 115 gr
- c. Format A3

3. Printim Roll up, 10 copë

- a. Përmasat 0.8*2 m
- b. Material banner + mekanizëm përkatës
- c. Roll up do të përmbajë 2 dizajn, konkretisht 1 dizajn për masat 1-6 dhe 7-9.

4. Reklamim « radio »

- a. Prodhim i 1 spoti radiofonik
- b. Transmetimi i spotit radiofonik në minimumi 3 radio kombëtare.
- c. Frekuenca jo më pak se 4 herë në ditë.

5. Minimumi 15 portale me te ndjekura informative online ku në të cilën të shfaqet informacioni për Hapjen e Thirrjes për Aplikim.

- 6. Reklamim në faqe sociale (facebook)** i spotit dhe 2 (dy) video trajnuese, ku minimumi i targetimit të audiencës është 100.000 përdorues në ditë, nëpërmjet “boost” të postimit në facebook AZHBR.
- 7. Video informuese/Pyetje Përgjigje (Live-Session), për transmetim në Facebook të AZHBR, me pjesëmarrjen e Stafit të AZHBR.**
 - **Organizimi do të merret përsipër nga operatori, kamera, mikrofon dhe lidhje live në Facebook.**
- 8. Monitorimi i procedurës së ndjekur nga kompani e specializuar që ushtrojnë këtë aktivitet dhe monitorimin e gjithë praktikës.**

Termet e referencës

1. Fletëpalosje

- Operatori merr përsipër të krijojë, tekstin dhe layout-in grafik të fletëpalosjeve.
- Fletëpalosja duhet të përmbajë slogan tekst logo
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për fletëpalosjen
- Fletëpalosja duhet të përmbajë logon e AZHBR MBZHR

Afati i dorëzimit 4 (katër) ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

2. Poster

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin tekstin dhe layout grafik të posterit, me kompozim të ndryshëm për 9 masat mbështetëse
- Posteri duhet të përmbajë fotografi, slogan tekst
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për posterin
- Posteri duhet të përmbajë logon e AZHBR, MBZHR.

Afati i dorëzimit 4 (katër) ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

3. Roll up

- Operatori merr përsipër të krijojë konceptin tekstin dhe layout grafik të posterit, me kompozim
- Roll up do të përmbajë 2 dizajn, konkretisht 1 dizanj për masat 1-6 dhe 7-9
- Roll up duhet të përmbajë slogan tekst logo
- Operatori merr përsipër shërbimin fotografik për fletëpalosjen
- Roll up duhet të përmbajë logon e AZHBR MBZHR

Afati i dorëzimit 4 (katër) ditë kalendarike nga nënshkrimi i kontratës.

- 4. Reklamimi në Facebook i spotit dhe 2 (dy) video trajnuese me qëllim arritjen e 100.000 përdorues në ditë.**

5. **Vlera e kontratës së shërbimit do të jetë: jo më shumë se 40 % ideim, krijim prodhim dhe pjesa tjetër prej 60 % e mbetur do të jetë për transmetim sipas media planit.**
6. **Të paraqitet një projekt ide-skenar për realizimin e shërbimit në CD.**
7. **Monitorimi i gjithë procedurës së ndjekur nga kompania të specializuara që ushtrojnë këtë aktivitet .afati i realizimit të shërbimeve si më sipër do të jetë deri në përfundim të afatit të skemave kombëtare.**

➤ **Dokumente ligjore që duhen paraqitur, si kriter kualifikues:**

- Ekstrakt historik i QKR, që vërteton se Operatori Ekonomik ushtron aktivitet ekonomik tregtar që përputhet me objektin e procedurës dhe është aktiv.
- Dokument nga organet kompetente që vërteton se operatori ekonomik ka shlyer detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën koherente.
- Vërtetim të xhiros vjetore të realizuar gjatë 3 viteve 2017-2018-2019.
- Vërtetim për numrin e punonjësve për periudhën Janar 2020-Janar 2021
- Deklaratë mbi gjëndjen gjyqësore, ku shprehet se Operatori ekonomik nuk ka ndjekje penale, si dhe nuk është dënuar me vendim të të formës së prerë nga gjykata, që lidhet me aktivitetin profesional.

➤ **Dokumentacioni financiar, si kriter kualifikues**

- Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare së bashku me nr. IBAN
- Kontratë të ngjajshme të realizuar gjatë tre viteve të fundit me shtetin (referencë ose kontratë) dhe/ose me subjekte private (faturat përkatëse dhe/ose kontrata).
- Sigurimin e ofertës në masën 2% të vlerës së fondit limit
- Deklaratën që subjekti nuk është në konflikt interesi;
- Deklaratën që i përmbush specifikimet dhe termat e referencës, deklaraten e konfidencialitetit.
- Formularin e ofertës
- Media plan paraprak për shpërndarjen/transmetim
- Deklaratë nga operatori ekonomik që transmetimi i reklamës do të jepet nga organet e masmedias, të cilat janë aktive dhe të licensuara sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentacioni të jetë origjinal ose kopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Kriteret e vlerësimit të subjekteve janë :

Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë; Projekt-ideja e realizimit të spoteve/reklamave, e cila përmban idejime/krijim, regji, montazh, efekte vizive dhe audio, stafi aktorëve, stafi ndihmues, etj
Projekt ideja do të vlerësohet nga Komisioni, në varësi të projekt idesë më të mirë të paraqitur.

Vlerësohet me 30 (tridhjetë) pikë; Koha televizive e blerë për transmetimin e Spoteve/reklamave (sipas logjikës së formulës më poshtë).

KT- Koha Televizive

KTM- Koha televizive me e madhe

KTV- Koha Televizive e që vlerësohet

$$KT = \frac{30 * KTV}{KTM}$$

Vlerësohet me 35 (tridhjetë e pesë) pikë; oferta më e ulët ekonomike në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta (sipas logjikës së formulës më poshtë).

OE- Oferta ekonomike

OU- Oferta më e ulët

OV- Oferta që vlerësohet

$$OE = \frac{35 * OU}{OV}$$

-Vlerësimi përfundimtar = pikët për projekt idenë + pikët për Kohën televizive + pikët për ofertën ekonomike.

Oferta duhet të jetë origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jenë të futur në zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj.

Mbi zarf të jetë shënuar **“ofertë për shërbimin”**. Përzgjedhja e ofertave do të realizohet sipas VKM nr. 1195, datë 5.8.2008, dhe kriterve të përshkruara dhe metodologjisë me sistemin e pikëve.

Monitorimi i publicitetit do të kryhet sipas përcaktimeve që do të vendosen në kontratën e shërbimit ndërmejt palëve.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë AZHBR në datën **12.03.2021, në ora 10.00.**

Në procesin e hapjes së ofertave kanë të drejtë të marrin pjesë Ofertuesit, apo personat me autorizim.

Komisioni pret konfirmimin nga organet e masmedias/të Agjencive të specializuara për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë jashtë këtij afati dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Pas analizimit të ofertave, të paraqitura nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara, komisioni përzgjedh, në bazë të pikëve, organet e masmedias/agjencitë e specializuara, duke u bazuar në kushtet e veçanta, të përcaktuara.

Ju falemnderit për bashkëpunimin.